



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.863/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, sipas padisë së paditësit Adol SH.P.K., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Koci & Vokshi, kundër të paditurit Sirius Wine N.T.P., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve SCLR Partners me avokat Q.Z., me objekt kontesti, shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarve të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.926/2022 të datës 27.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e autorizuarve të paditësit Adol SH.P.K., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Koci & Vokshi.

II. VËRTETOHET Aktgjykimit i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.926/2022 i datës 27.04.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar KE.nr.926/2022 të datës 27.04.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit Adol SH.P.K., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me të cilën ka kërkuar të aprovet padia, si faktikisht ashtu dhe juridikisht dhe të vërtetohet që i padituri Sirius Wine N.T.P me seli në Prishtinë ka tentuar të lëshojë në qarkullim produktet e ndaluara në Doganën e Kosovës, duke bërë cenimin e markës tregtare të paditësit. Në pikën II të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit SH.P.K., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me të cilën ka kërkuar lejimin e shkatërrimit të mallrave: Pije alkoolike Brandy Skënderbeu Premium, 60 pako x 6 Pce = 360 Pce x 0.7L = 252 Ltr, që shkelin markën tregtare nr. 8232, nr. 8230 dhe 17665 dhe të obligohet i padituri Sirius Wine N.T.P me seli në Prishtinë që nën mbikëqyrjen e Doganës së Kosovës të bëjë shkatërrimin e mallit në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Në pikën III të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Adol SH.P.K me seli në Tiranë,

Republika e Shqipërisë, me të cilën ka kërkuar që i padituri Sirius Wine N.T.P me seli në Prishtinë, të paguajë shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimit të mallit Pije alkoolike Brandy Skënderbeu Premium, 60 pako x 6 Pce = 360 Pce x 0.7L = 252 Ltr, në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën IV të dispozitivit secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të shkaktuara në këtë procedurë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë të autorizuarit e paditësi për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, ose të aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi, pranë gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar padi kundër së paditurës për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të miratohet si e bazuar, me arsye si në precizin të kërkesëpadiës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar KE.nr.926/2022 të datës 27.04.2023, me të cilin ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit të gjendjes faktike erdhi në përfundim se pala e paditur Sirius Wine nuk e ka shkelur markën tregtare të paditësit Adol SH.P.K., sepse marka e mirënjohur Gjergj Kastrioti Skënderbeu ka qenë prezentë në tregun e Republikës së Kosovës edhe para regjistrimit, pra para vitit 2007. Prandaj kjo gjendje faktike gjënë zbatim në nenin 7 par.2, nën par.4 të Ligjit për Markat Tregtare, dhe tutje duke ju referuar nenit 6bis të Konventës së Parisit, dhe gjithashtu edhe Marrëveshjes së TRIPS, përkatësisht nenit 16.2 që parasheh se çka duhet të merret parasysh për përcaktimin e markës së mirënjohur që është njohuria për atë markë tregtare në pjesën përbërëse të publikut, duke përfshirë edhe njohurinë e pranisë në atë vend të arritur si rezultat i promovimit të markës tregtare, gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk mund të kërkojë në këtë rast mbrojtje juridike për një markë të mirënjohur. Paditësi përdor shqiponjën dy krenare pjesë e Flamurit Kombëtar Shqiptar, pra këtë shenjë e përdor përkrenaren e Skënderbeut që është simbol kombëtar, të gjitha këto sipas dispozitave të nenit 6 të Ligjit për Marka Tregtare (LMT) nuk mund të regjistrohen si të tilla, andaj rrjedhimisht nuk gëzojnë mbrojtje juridike.

Kolegji i Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke gjetur se e njëjta është e pabazuar. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Në arsyetimin e aktgjyqimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike dhe arsye mbi të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Parashtrimet në ankesë nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktgjyqimit të ankimuar. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë po ashtu vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo gjykatë e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, ku vërtetohet se i padituri nuk ka shkelur markën tregtare të paditësit për shkak se mbrojtja e shenjave që përbejnë simbole kombëtare nuk mund të përvetësohen vetëm nga një palë dhe tu ndalohej palëve të tjera përdorimi i tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktgjyqimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyqimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, ku nga kjo rezulton se aktgjykimi i ankimuar përmban të gjitha elementet e kërkuara me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe si rezultat i së cilës edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë çështje juridike nuk kemi të bëjmë me shkelje të markës tregtare ashtu siç pretendon pala paditëse, kjo për faktin se në rastin konkret paditësi pretendon mbrojtja e shenjave që përbejnë simbole kombëtare, mirëpo sipas kësaj gjykate pala paditëse nuk mund të gëzojë të drejtën e ekskluzivitetit vetëm pse ka regjistruar këto simbole si marka tregtare duke ju ndaluar kështu përdorimi palëve të treta.

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Markat Tregtare, konkretisht në neni 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.8, në mënyrë shprehimore përcaktohet se cilat marka tregtare nuk mund të regjistrohen dhe nëse

janë regjistruar, duhet të shpallen të pavlefshme: “markat tregtare që nuk janë autorizuar nga autoritetet kompetente në pajtim me nenin 6 të Konventës së Parisit”. Kurse me nën paragrafi 1.10, theksohet se: “markat tregtare të cilat përmbajnë simbole, emblema dhe stema shtetërore që nuk janë përcaktuar në nenin 6 të Konventës së Parisit dhe që janë në interesin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përveç në rastet kur regjistrimi i tyre lejohet nga organi kompetent”.

Ndërsa me Konventën e Parisit konkretisht me nenin 6 te, përcaktohet se: “Vendet e Unionit pajtohen që në mungesë të lejes nga autoritetet përkatëse, të refuzojnë ose anulojnë regjistrimin dhe të ndalojnë, me mjete adekuate, përdorimin e cilitdo lloj të shenjave fabrikimi ose tregtare, qoftë sikur pjesë përbërëse e këtyre shenjave, emblemave, flamujve dhe emblemave të tjera shtetërore të vendeve të Unionit, shenjave zyrtare dhe shenjave për kontroll dhe garanci, që i kanë miratuar ata, si dhe çdo mbështetje në dukje heraldike”. Andaj, nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton se kërkesëpadia e paditësit nuk gjënjë mbështetje ligjore pasi që simbolet kombëtare hynë në kategorinë e markave tregtare me përmbajtje të paautorizuar, që nënkupton se në rastin konkret pala e tretë konkretisht i padituri ka të drejtën e përdorimit të këtyre simboleve kombëtare.

Gjykata ankimore nuk është lëshuar në pretendimin ankimore të autorizuarit të paditësit lidhur me atë së gjykata e shkallës së parë ka vendosur për një pjesë të kërkesëpadiës për të cilën i njëjti është tërhequr, meqenëse se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit është refuzuar në tërësi.

Nga sa u parashtrua e në mbështetje të dispozitës së nenit 200 të LPK është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.863/2023, me datë 08.02.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi